

KËRKESË ANKIMORE

Drejtuar: Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS)

në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Adresa: Rruga " Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr.4: Tiranë



ANKUESI

Partia "Lëvizja Shqipëria Bëhet"

Rr. Jeronim de Rada, Tirane. av.dorinaprethi@gmail.com; 0685659387

OBJEKTI I ANKIMIT

Ndryshimin e Vendimit Nr. __, dt. 23.07.2025, të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve "Për caktimin e kandidatëve fitues të subjektit zgjedhor Koalicioni "Nisma Shqipëria Bëhet" në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.

2.Kundërshtimi i Vendimit të KSHZ

Vendimi		Titulli i Vendimit
Nr.	Datë	
	23/07/2025	

Bazuar në nenin 21, 123/1, 124, 124/1 dhe 126, neni 160, pika 2 dhe 3, neni 161, pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar

Kushtetuta e R. Sh, Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë Ligji Nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për partitë politike" Tiranë, më 21.07.2025, Kodi i Procedurave Administrative të R.Sh

PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR



ANKIM

- ANKUES:** Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, e regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me Nr. Vendimi 5, dt. 30.09.2024, përfaqësuar nga Kryetari Adriatik Lapaj.
- OBEKT:** Ndryshimin e Vendimit Nr. ___, dt. 23.07.2025, të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kandidatëve fitues të subjektit zgjedhor Koalicioni “Nisma Shqipëria Bëhet” në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
- DREJTUAR:** Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
- BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e R. Sh
Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë
Ligji Nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për partitë politike” Tiranë, më 21.07.2025
Kodi i Procedurave Administrative të R.Sh Neni 130 e vijues.

Të nderuar,

Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, e regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me Nr. Vendimi 5, dt. 30.09.2024 është regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me Vendimin Nr. 237, datë 04.03.2025, si koalicion për zgjedhjet parlamentare të datës 11 maj 2025 me emërtimin Nisma “Shqipëria Bëhet”.
Për efekt të regjistrimit është depozituar edhe Marrëveshja e Koalicionit, në të cilën subjektet pjesëmarrëse janë angazhuar për përmbushjen e dokumentacionit për garimin në zgjedhje.

I. LEGJITIMIMI

Sipas nenit 65 pika 1 të Kodit Zgjedhor:

“1. Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve”

Sipas nenit 65 pika 3 të Kodit Zgjedhor:

“3. Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.”

Lëvizja Shqipëria Bëhet e regjistruar si subjekt zgjedhor e më pas si koalicion me 2 parti të tjera ndër të cilat partia “Nisma Thurje” dhe lëvizja Për te Drejtat e punëtorëve Shqiptarë, gëzon legjitimitet të plotë aktiv për të paraqitur përpara KQZ këtë ankim pasi është subjekt i shpërndarjes së mandateve për Qarkun Tiranë, përmes Vendimit Nr. ___, dt. 23.07.2025 të KQZ.

Nisur nga sa më sipër, brenda afatit ligjor prej 3 ditësh, po depozitjmë përpëra KAS, ankimin Për Kundërshtimin e Vendimit Nr. _____, dt. 23.07.2025 të KQZ.

II. JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCA

Sipas parashikimeve të Nenit 124/1 pika 2:

2. Kundër akteve të Komisionerit lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit. Në periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatatit përfundimtar, ankimi paraqitet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit. Për periudhën tjetër, ankimi paraqitet brenda 30 ditëve nga dalja e vendimit.

III. LIGJI I APLIKUESHËM

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 48 i Kushtetutës: *“Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.”*

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

Neni 73 pika 4 Verifikimi i Dokumentacionit

“Emrat në listat shumëemërore dhe renditja e tyre nuk mund të ndryshohen pas miratimit përfundimtar nga ana e KQZ-s”.

Kodi i Procedurave Administrative

Neni 91 - Afati për përfundimin e procedurës administrative

1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm.

2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.

Neni 97 - Miratimi në heshtje

1. Nëse pala ka kërkuar në procedurën administrative nxjerrjen e një akti administrativ shkresor dhe organi publik nuk njofton vendimin brenda afatit të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor për përfundimin e procedurës dhe nuk njofton zgjatjen e afatit ose nuk njofton vendimin brenda afatit të zgjatur, kërkesa konsiderohet si e miratuar dhe akti administrativ shkresor i kërkuar si i miratuar në heshtje (akti në heshtje) në rastet kur është parashikuar nga ligje të veçanta.

2. Pala ka të drejtë të kërkojë nga autoriteti publik, i cili nuk ka nxjerrë aktin administrativ të kërkuar, një konfirmim me shkrim se kërkesa e saj konsiderohet të jetë miratuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Konfirmimi përmban tekstin e kërkesës, datën e paraqitjes së saj dhe faktin që organi publik nuk ka njoftuar vendimin e tij brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni.

IV. ANALIZA JURIDIKE E FAKTEVE

Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, e regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me Nr. Vendimi 5, dt. 30.09.2024 është regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me Vendimin Nr. 237, datë 04.03.2025, si koalicion për zgjedhjet parlamentare të datës 11 maj 2025 me emërtimin Nisma “Shqipëria Bëhet”.

Për efekt të regjistrimit është depozituar edhe Marrëveshja e Koalicionit, në të cilën subjektet pjesëmarrëse janë angazhuar për përmbushjen e dokumentacionit për garimin në zgjedhje.

Ky koalicion ka marrë 16,520 vota në Qarkun Tiranë, duke fituar **një mandat përfaqësimi**. Të gjithë kandidatët e listës së mbyllur për këtë qark, kanë **paraqitur dorëheqjen nga kandidimi përpara fillimit të numërimit të votave** – më datë 11 maj 2025.

Sa më sipër, në përmbajtje të dorëheqjeve të tyre kandidatët e listës së mbyllur kane argumentuar se japin dorëheqje nga kandidimi, duke refuzuar të përfaqësojnë një mandat deputeti.

Akti juridik i dorëheqjes nga kandidimi është përfundimtar dhe sjell pasoja të menjëhershme në **momentin e paraqitjes së tij**, duke e përjashtuar kandidatin nga çdo e drejtë për të përfituar mandat. Personat që janë tërhequr nuk janë më subjekte garuese dhe **nuk mund të konsiderohen më pjesë e listës zgjedhore**, pavarësisht se emri i tyre figuron në listë për shkak të faktit që ajo është e printuar.

Sipas nenit 73, pika 4, të Kodit Zgjedhor, lista nuk mund të ndryshohet për efekt të printimit të saj, por kjo nuk e ndalon tërheqjen nga kandidimi dhe as nuk imponon detyrim që kandidati të mbetet në garë. Ligji nuk detyron askënd të marrë pjesë në një procedurë zgjedhore kundër vullnetit të tij, pasi kjo cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese të individit.

Për analogji sjellim rastin e disa kandidatëve nga listat e hapura të cilët u tërhoqën nga gara, pas miratimit të listave dhe printimit të fletëve të votimit. Në këtë rast KQZ, mori vendim duke i përjashtuar ata nga përfitimi i mandatit edhe në rast se do të ishin votuar.

Të njëjtën logjikë kemi ruajtur, kur kërkuam në arsyetimin tonë që KQZ do të duhej të kishte dalë me një vendimarrje, marrë këtu parasysh faktin që kishte edhe një precedent nga Zgjedhjet 2021 “Rasti Tom Doshi” i cili parashtrroi dorëheqjen në ditën e zgjedhjeve ¹

Në momentin e depozitimit të këtyre kërkesave, organi publik Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pasur 60 ditë kohë të shprehej sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 48, i cili parashikon se kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj. Nga ana tjetër, neni 91, pika 2, i Kodit të Procedurës Administrative parashikon se në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë. Duke qenë se për rastin konkret Kodi Zgjedhor nuk ka parashikim të posaçëm, na lind detyrimi t’i drejtohem dispozitave të përgjithshme. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka qenë i detyruar të përgjigjet duke pranuar, refuzuar apo shtyrë afatet e këtyre kërkesave, gjë që nuk është bërë. Në kushtet kur nuk e ka ushtruar këtë detyrim, sipas nenit 97 të Kodit të Procedurave Administrative, nëse organi publik nuk merr një vendim brenda afatit, nuk njofton zgjatjen e këtij vendimi, apo nuk njofton vendim brenda afatit të zgjatur, atëherë kërkesa konsiderohet e miratuar në heshtje.

Në këtë rast, për sa kohë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk u shpreh me vendim për të refuzuar ose për të pranuar dorëheqjet në kohën e paraqitjes së tyre, ato konsiderohen të miratuara në heshtje dhe ne si partia udhëheqëse e Koalicionit kemi kërkuar konfirmimin e miratimit të heshtur në datën 17.7.2025. Për

¹ Vendimi nr.410 date 23.06.2021

Tel: +355 69 955 4829

Email: info@shqiperiabehet.al

Adresa: Rr. Jeronim De Rada, Tiranë

web: www.shqiperiabehet.al

referencë, në datën 10.7.2025 është plotësuar afati 60-ditor në të cilin KQZ-ja duhet të ishte shprehur. Për më tepër një nga kandidatët e listës së mbyllur ka revokuar dorëheqjen në datën 15.7.2025, pas tejkalimit të afateve kur do të duhej të ishte bërë miratimi i heshtur.

Konform **Nenit 97 të Kodit të Procedurave Administrative**, nëse organi publik nuk reagon në një nga mënyrat e parashikuara në këtë nen, kërkesa quhet e miratuar ne heshtje. Rasti në fjalë, është një nga rastet tipike të miratimit në heshtje. Me kalimin e afatit konsiderohet e miratuar ne heshtje dhe nuk mund të hyjmë në interpretim mbi mandatin, thelbin

Refuzimi për tu përgjigjur në afat dhe shkelja e **Nenit 97 të K.Pr.Administrative**, apo mosrespektimi i afatit për marrjen e një vendimi nuk është një çështje formale apo thjesht procedurale; ai cënon sigurinë juridike të subjekteve dhe shkakton pasiguri në marrëdhëniet institucionale dhe në rendin juridik. Siguria juridike është një garanci kushtetuese dhe një element bazë i parimit të shtetit të së drejtës, e cila kërkon që:

- qytetarët të jenë në dijeni të të drejtave dhe detyrimeve të tyre,
- procedurat të jenë të parashikueshme,
- institucionet të veprojnë në përputhje me ligjin dhe në kohë të arsyeshme.

Kur një institucion si KQZ nuk reagon, ai jo vetëm që **minon sigurinë e marrëdhënieve zgjedhore**, por edhe **kompromenton integritetin e të gjithë procesit zgjedhor**, i cili duhet të bazohet në qartësi dhe parashikueshmëri.

Në rastin konkret, **heshtja e KQZ-së**, përtej aspektit të shkeljes ligjore formale, përbën një formë **refuzimi të heshtur për të ushtruar funksionin ligjor**, duke nxitur një situatë pasigurie dhe paqartësie mbi mënyrën e shpërndarjes së mandatit, mbi vlefshmërinë e akteve të dorëheqjes dhe mbi vetë besueshmërinë e sistemit zgjedhor.

KQZ në vendimin e saj ka marrë në shqyrtim dy çështje kryesore:

- a) *A do të konsiderohen si kandidatë për deputetë që prej datës 11 maj 2025 e më pas, dymbëdhjetë personat e përfshirë në listën e mbyllur të këtij subjekti zgjedhor, të cilët po në këtë datë kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një deklaratë për dorëheqjeje nga kandidimi dhe nga marrja e mandatit?*

Në lidhje me këtë pyetje të shtruar, sqarojmë se:

1. **KQZ**, argumenton se për sa kohë që ekziston ligji i posacëm, do aplikohet ligji i posacëm, por ndërkohë nuk referon në asnjë nen ku e bazon këtë argument.

Vete KQZ në vendim, argumenton se “Kodi Zgjedhor nuk parashikon asnjë detyrim për KQZ për shqyrtim të kërkesave të tilla në këtë rast. Ose më së paku afate për shqyrtimin e kërkesave të tilla”.

Për sa kohë që ligji i posacëm nuk parashikon një afat specifik, sikurse vetë KQZ pohon, atëherë për referencë trajtohet sipas parashikimeve të ligjit të përgjithshëm, Kodin e Procedurave Administrative. Pra KQZ kishte detyrimin të shprehej me vendim brenda afatit 60 ditë. Duke qenë se nuk është shprehur me akt administrativ, dorëheqjet e depozitura, konsiderohen të miratuara në heshtje.

2. **Sa i takon argumentit se nëse një kandidat paraqet një kërkesë për tërheqje nga kandidimi, apo një subjekt paraqet një kërkesë për ndryshime në listën shumemërore pas miratimit përfundimtar nga ana e KQZ-së të listës shumemërore, atëherë kjo kërkesë është absolutisht e pabazuar në ligj, me arsyetimin se “Emrat në listat shumemërore dhe renditja e tyre nuk mund të ndryshohen pas miratimit përfundimtar nga ana e KQZ-së”.**

Nuk qëndron sepse ne nuk kemi depozituar kërkesë për rishikimin e listave, por kërkesë për tërheqje nga kandidimi, që është vullneti shprehur i kandidatëve pjesë e listave të miratuara. (si në rastin e kandidatëve të tërhequr nga lista e hapur, Averdë Sylja (Qarku Kukës); dhe Joan Sotir (Qarku Korçë).

3. **Sa i takon argumentit: “Nga ana tjetër, le të pranojmë për momentin se këta persona/kandidatë nuk e kanë më këtë cilësi që prej datës 11 maj 2025. Nëse do të jetë kështu, atëherë do të ishim përpara faktit se lista shumemërore nuk do të përmbushte kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe si e tillë do të refuzohej nga KQZ. Me këtë rast subjekti zgjedhor përkatës nuk do të mund të merrte pjesë në zgjedhje për shkak të mungesës së një liste të vlefshme kandidatësh sipas kërkesave të Kodit Zgjedhor.**

Shpjegojmë se në vazhdim edhe të pikës 2, lista e Qarkut Kukës dhe Qarkut Korçë, ishin të miratuara, të vlefshme dhe të ligjshme, pavarësisht faktit se 2 kandidatët e sipërpërmendur kishin dhënë dorëheqjen dhe nuk ishin defakto kandidatë në zgjedhjet 2025. Me të njëjtën logjikë, KQZ duhet të kishte vepruar edhe për dorëheqjet e paraqitura në dt 11 maj 2025, duke i lënë këta kandidatë në listat shumëemërore të miratuara më parë, por që defakto nuk do të ishin në garë, pasi kishin hequr dorë nga kandidimi.

Pra, nuk qëndron lidhja që KQZ bën mes vlefshmërisë së listave, dhe mosmarrjes pjesë në zgjedhje të subjektit zgjedhor (pasi lista shumëemërore ishte miratuar me vendim të mëparshëm).

Cila dispozitë ligjore e pengoi KQZ-në të shprehej për dorëheqjet e listës së mbyllur, sikurse ka vepruar për dy kandidatët e dorëhequr të listës së hapur të miratuar me vendim, dorëheqja e të cilëve nuk e çënoi listën përfundimtare të miratuar?!

Pjesë e këtij procesi ankimimi duhet të jetë edhe interpretimi dhe unifikimi i praktikave të ndryshme që ka ndjekur KQZ për të njëjtin objekt.

Në asnjë rast nuk mund të detyrohet një shtetas të marrë pjesë në një procedurë tej vullnetit të tij pasi kjo do të çënonte thelbin e të drejtave dhe lirive kushtetuese. Heqja dorë nga kandidimi nuk do të thotë ndryshim i listës apo cregjistrim nga lista duke lënë vakanca në aspektin formal të saj. Heqja dorë nga kandidimi lidhet me pasojat juridike që rrjedhin nga të qenit kandidat, pra subjekti nuk kërkon të ketë më të drejta dhe detyrime në lidhje me procesin në fjalë.

Nuk mundet kurrësi të pranohet si argument fakti që ligji nuk ka parashikime të plota në lidhje me tërheqjen nga kandidimi pas miratimit të listave për të penguar një shtetas të ushtrojë të drejtën e vet. **Nëse nevoja për të pasur lista të plota është argumenti juridik për çështjen në fjalë, atëherë si do vepronte KQZ në rastin hipotetik të refuzimit për të marrë mandatin nga të gjithë kandidatët e listës së mbyllur dhe hapur për qarkun Tiranë? Do të detyronte një prej kandidatëve të merrte mandatin me argumentin se Parlamenti do të mbetej me 139 deputetë?**

4. Sa i takon argumentit: “Së fundmi, nuk është e nevojshme të ndalemi në argumentimin se është pa kuptim dhe pa pasojë tërheqja nga kandidimi në ditën e zgjedhjeve, apo edhe më pas”.

Fakti që KQZ përmend që ky akt është pa pasojë në ditën e zgjedhjeve apo më pas, është pikërisht për faktin se KQZ REFUZOI TË SHPREHEJ DHE E LA KËTË AKT PA PRODHUAR PASOJA JURIDIKE.

Në lidhje me çështjen e dytë të ngritur nga KQZ:

b) Në këtë fazë të procesit zgjedhor, kur ende nga KQZ nuk është vendosur shpërndarja e mandateve dhe shpallja e kandidatëve fitues për një subjekt zgjedhor, a është e lejueshme që një kandidat i listës shumëëmërore të këtij subjekti të deklarojë se nuk dëshiron të marrë mandatin e deputetit, nëse ai do t'i takojë? Në vijim të kësaj pyetjeje, a është ky kandidat në të drejtën e tij, që një deklaratë me përmbajtje të tillë ta paraqesë në KQZ, në çdo moment përpara shpërndarjes së mandateve dhe shpalljes së kandidatëve fitues?

Çështja që ngre KQZ-ja nuk ka lidhje me situatën në të cilën ndodhemi. Jemi përpara situatës që 12 kandidatët kanë shprehur vullnetin me shkrim në datën 11 maj për tu dorëhequr nga kandidimi, dhe nëse KQZ do të kishte përmbushur detyrimin ligjor për të dalë me një akt administrativ (të miratimit, refuzimit apo të cfarëdo forme dhe përmbajtje), do të ndodheshim përpara faktit që KQZ nuk do t'i hynte fare këtij diskutimi, por do të kishte proceduar me djegien e listës së mbyllur dhe do të kishte proceduar me kalimin e mandatit tek më i votuari i listës së hapur.

Në kushtet kur KQZ nuk ka vepruar në përputhje me ligjin, e ka vendosur subjektin zgjedhor në një pasiguri juridike në raport me gjithë subjektet e tjera zgjedhore, duke krijuar një precedent të rrezikshëm për sistemin zgjedhor dhe fuqinë institucionale, duke e nëpërkëmbur marrëdhënien mes institucionit dhe individit. Kjo për faktin se heshtja e KQZ ka krijuar kushtet për të vesuar vullnetin e kandidatëve të tërhequr.

Pjesë e këtij procesi ankimimi duhet të jetë edhe interpretimi dhe unifikimi i praktikave të ndryshme që ka ndjekur KQZ duke zbatuar rastin e precedentit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021 ku kandidati Tom Doshi u tërhoq nga kandidimi ditën e zgjedhjeve dhe KQZ u shpreh me vendim, një ditë pas këtij akti. A i ndryshoi KQZ në këtë rast listat shumëëmërore?! A përbënte ky fakt për KQZ arsye për ta quajtur këtë veprim si ndryshim i listave shumëëmërore në kundërshtim me Nenin 73/4 të Kodit Zgjedhor?!

Në përfundim kërkojmë:

1. Ndryshimin e Vendimit Nr. ____, dt. 23.07.2025, të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kandidatëve fitues të subjektit zgjedhor Koalicioni “Nisma Shqipëria Bëhet” në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
2. Mosnjohjen si të vlefshme të revokimit të dorëheqjeve të depozituara përkatësisht në datë 15.07.2025 nga Zeqir Kordhoni dhe në dt.17.07.2025 nga Kleana Xhuveli.
3. Shpalljen e kandidatit fitues nga lista shumëëmërore sipas numrit të votave parapëlqyese, të subjektit zgjedhor Koalicioni “Nisma Shqipëria Bëhet” për Qarkun Tiranë, si më poshtë:

1. Adriatik Ferman Lapaj – SHB

4. Miratimin e kandidatëve të mbetur, të cilët nuk kanë përfituar mandat në listën shumemërore të subjektit zgjedhore Koalicioni “Nisma Shqipëria Bëhet” në bazë të renditjes sipas numrit të votave parapëlqyese, duke filluar nga numri më i lartë i votave dhe duke zbatuar kriterin gjinor.

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese	
2.	Endrit	Skënder	Shabani	M	3032	NISMA
3.	Greta	Piro	Ambeli	F	644	SHB
4.	Panajot	Foto	Soko	M	754	NISMA
5.	Ervis	Përparim	Çela	M	494	SHB
6.	Edona	Niman	Haklaj	F	410	SHB
7.	Erjon	Aleksandër	Bacaj	M	261	SHB
8.	Dorina	Lek	Prethi	F	259	SHB
9.	Alfred	Lek	Matoshi	M	201	SHB
10.	Fjoralb	Ferit	Shehi	M	196	SHB
11.	Eduart	Ramiz	Kaca	M	174	SHB
12.	Luana	Fatos	Harizaj	F	141	SHB
13.	Brunilda	Bashkim	Salaj	F	141	LDPSH
14.	Ferdinand	Asqeri	Dervishi	M	134	SHB
15.	Hajdër	Isuf	Koxha	M	109	NISMA
16.	Najada	Sotir	Kambo	F	105	SHB
17.	Taulant	Kujtim	Hoxha	M	104	SHB
18.	Brunilda	Bardhosh	Dhrami	F	98	NISMA
19.	Denis	Zenel	Dulla	M	87	SHB
20.	Marjus	Flamur	Malaj	M	87	LDPSH
21.	Anica	Klementi	Papadhima	F	84	SHB
22.	Klodjan	Thoma	Kaçani	M	86	NISMA
23.	Franc	Amatus	Jakova	M	74	NISMA
24.	Ariel	Dritan	Muka	F	59	NISMA
25.	Ismail	Misir	Tafari	M	65	SHB
26.	Alban	Niazi	Nelaj	M	64	NISMA
27.	Valdete	Ismail	Kordhoni	F	37	NISMA
28.	Gëzim	Shimë	Leka	M	52	LDPSH
29.	Klajdi	Sulejman	Qehaja	M	49	NISMA
30.	Justi	Dhimitraq	Hysi	F	35	NISMA
31.	Gjergji	Vaskë	Korçari	M	43	SHB
32.	Flamur	Zenel	Stoli	M	38	NISMA
33.	Juliana	Kujtim	Nebaj	F	23	SHB
34.	Klajdi	Astrit	Nallbani	M	36	SHB
35.	Olsi	Gëzim	Preza	M	32	LDPSH
36.	Armando	Olsi	Shtylla	M	24	SHB
37.	Marsel	Ilir	Rupi	M	13	NISMA

Me respekt,

Përfaqësuesi për komunikimin me KQZ

Av. Dorina Prethi

Kërkojmë nga Adminstrata e KQZ që për efekt të këtij procesi të vihet në dispozicion të KAS,
dokumentat e mëposhtme:

1. Akti i Dorëheqjes nga lista e mbyllur për Qarkun Tiranë, e depozituar me dt. Maj -2025
2. Letra e revokimit nga ana e Zeqir Kordhoni dt. 15.07.2025
3. Letra e revokimit nga ana e Kleana Xhuvelit dt. 17.07.2025



Nr. 5635 pr
Dt. 21.07.2025
— Clu

Nr. 91/1 Protokolli

Tiranë, më 21/07/2025

KËRKESË

- LËNDA:** Konfirmim i miratimit të heshtur të kërkesave për dorëheqjet e listës së mbyllur në listën e kandidatëve të Qarkut Tiranë.
- DREJTUAR:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
- BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e R. Sh
Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.
Ligji Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative

I nderuar z. Komisioner,

Nisma "Shqipëria Bëhet" me Vendimin Nr. 237, dt. 04.03.2025, është regjistruar në KQZ si koalicion për zgjedhjet parlamentare të dt. 11 maj 2025, me pwrfaqwsues z. Adriatik Lapaj në cilësinë e drejtuesit të koalicionit.

Në Qarkun Tiranë, ky koalicion ka siguruar **16,520 vota**, duke fituar **një mandat përfaqësimi**. Ju bëjmë me dije se të gjithë kandidatët e listës së mbyllur për këtë qark kanë paraqitur dorëheqjen nga kandidimi, më datë **11 maj 2025**, përpara fillimit të procesit të numërimit të votave.

Bazuar në Nenin 97, të Kodit të Procedurave Administrative, përsa kohë organi publik, në këtë rast Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk është shprehur me vendim konsiderohen të miratuara në heshtje.

Në këtë kuadër, **kërkojmë konfirmimin me shkrim se dorëheqjet e paraqitura janë konsideruar të miratuara në heshtje, në përputhje me ligjin në fuqi.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Me respekt,
Përfaqësuesi për komunikimin me KQZ
Av. Dorina Prethi

Tel: +355 69 955 4829
Email: info@shqiperiabehet.al

Adresa: Rr. Jeronim De Rada, Tiranë
web: www.shqiperiabehet.al

Nr. 5608 prot
Dt. 14.07.2025
GK



Nr. 90/1 Protokolli

Tiranë, më 17.07 2025

KËRKESË

LËNDA: Njohjen e dorëheqjeve nga kandidimi i listës së mbyllur për Qarkun Tiranë

DREJTUAR: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e R. Sh
Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.
Ligji Nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për partitë politike"

I nderuar z. Komisioner,

Nisma "Shqipëria Bëhet", me Vendimin nr. 237, datë 04.03.2025, është regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si koalicion për zgjedhjet parlamentare të datës 11 maj 2025, me z. Adriatik Lapaj në cilësinë e drejtuesit të koalicionit.

Ky koalicion ka marrë 16,520 vota në Qarkun Tiranë, duke fituar një (1) mandat përfaqësimi. Ju bëjmë me dije se kandidatët e listës së mbyllur për këtë qark kanë paraqitur dorëheqjen nga **kandidimi**, përpara nisjes së procesit të numërimit të votave. Kjo është një dorëheqje **nga kandidimi**, jo nga mandati, pasi mandati në këtë fazë nuk ekzistonte ende dhe nuk mund të heqesh dorë nga një ngjarje e së ardhmes.


Çdo ndryshim i mëvonshëm i qëndrimit nga ana e këtyre kandidatëve është i pavlefshëm në aspektin juridik dhe nuk prodhon pasoja, pasi vlefshmërinë e ka vetëm akti i parë – dorëheqja nga kandidimi.

Në kuptimin juridik, dorëheqja sjell pasoja të menjëhershme në momentin e paraqitjes së saj. Në kontekstin elektoral, dorëheqja nga kandidimi është një akt përfundimtar dhe i pakthyeshëm, që përjashton kandidatin nga çdo e drejtë për të marrë mandat. Duke u tërhequr nga kandidimi, ata nuk kanë qenë më subjekt garues për zgjedhjet e 11 majit 2025. Në këtë mënyrë, e kanë përjashtuar veten nga lista zgjedhore, dhe veprimi i tyre nuk mund të zhbëhet më pas me asnjë deklaratë të mëvonshme, pasi nuk kanë qenë më pjesë e garës zgjedhore.

Në kushtet kur kemi të bëjmë me një **heqje dorë nga kandidimi** dhe jo me **dorëheqje nga mandati**, ligji kërkon që mandati të kalojë tek kandidati pasues në listë, në përputhje me rregullat për zëvendësimin e mandateve. Për këtë arsye, kërkojmë që të procedohet me shpërndarjen e mandatit të fituar në Qarkun Tiranë, sipas listës përkatëse të hapur.

Me respekt,
Përfaqësuese për Komunikimin me KOZ
Ay. Dorina Prethi

Tel: +355 69 955 4829
Email: info@shqiperiabehet.al



Adresa: Rr. Jeronim De Rada, Tiranë
Web: www.shqiperiabehet.al



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Qershor 2021

Nr: 410

V E N D I M

**PËR SHPËRNDARJEN E MANDATEVE MIDIS SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE
PËRCAKTIMIN E KANDIDATËVE FITUES NË ZONËN ZGJEDHORE QARKU SHKODËR
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25.04.2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 162 dhe 163, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për Kuvendin dhe për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo deputet, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 342, datë 4.05.2021, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore për zonën zgjedhore Qarku Shkodër. Kundër këtij vendimi, brenda afateve ligjore u paraqitën kërkesa ankimore ku midis të tjerash u kundërshtua dhe Vendimi nr. 342, datë 4.05.2021. Në përfundim të shqyrtimit të ankimeve Kolegji Zgjedhor vendosi lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, Komisioneri në mbështetje të nenit 162, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, përllogarit shpërndarjen e mandateve për Kuvendin.

Në bazë të nenit 162, pika 1, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve subjektet zgjedhore që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Subjektet zgjedhore që plotësojnë kushtin për t’u përfshirë në përllogaritjen e shpërndarjes së mandateve janë:



Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1.	Partia Socialiste e Shqipërisë	768.134	48,67%
2.	Koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim"	622.187	39,42%
3.	Lëvizja Socialiste për Integrim	107.538	6,81%
4.	Partia Socialdemokrate	35.475	2,25%

Rezultati për Qarkun Shkodër për subjektet zgjedhore, sipas vendimit nr. 342, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1	Partia Socialdemokrate	16.425	15,24%
2	Partia Balli Kombëtar	151	0,14%
3	Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare	229	0,21%
4	Partia Bindja Demokratike	1.005	0,93%
5	Koalicioni "Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët"	96	0,09%
6	Lëvizja Socialiste për Integrim	10.100	9,37%
7	Partia Nisma Thurje	518	0,48%
8	Partia Lëvizja e Re	115	0,11%
9	Koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim"	47.205	43,80%
10	Partia Aleanca Demokracia e Re	126	0,12%
11	Partia Lëvizja Për Ndryshim	1.389	1,29%
12	Partia Socialiste e Shqipërisë	30.296	28,11%
13	Pal Shkambi	126	0,12%
Totali i votave të vlefshme		107.781	100,00%

Subjektet zgjedhore që plotësojnë kushtin për t'u përfshirë në përlogaritjen e shpërndarjes së mandateve kanë fituar vota si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota
1	Koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim"	47.205
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	30.296
3	Partia Socialdemokrate	16.425
4	Lëvizja Socialiste për Integrim	10.100

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 11 (njëmbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore qarku Shkodër, që në bazë të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 7, datë 11.12.2020.



Subjekti zgjedhor/ pjesëtuesit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Herësit
PD-AN	47.205	23.603	15.735	11.801	9.441	7.868	6.744	5.901	5.245	
PS	30.296	15.148	10.099	7.574	6.059	5.049	4.328	3.787	3.366	
PSD	16.425	8.213	5.475	4.106	3.285	2.738	2.346	2.053	1.825	
LSI	10.100	5.050	3.367	2.525	2.020	1.683	1.443	1.263	1.122	

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përfshirë nga çdo pjesëtim, renditen nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore qarku Shkodër, pra 11. Nga kjo renditje marrim rezultatin si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Herësit
1	PD-AN	47.205
2	PS	30.296
3	PD-AN	23.603
4	PSD	16.425
5	PD-AN	15.735
6	PS	15.148
7	PD-AN	11.801
8	LSI	10.100
9	PS	10.099
10	PD-AN	9.441
11	PSD	8.213

Në bazë të nenit 162, pika 5, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Sipas nenit 163, pika 1, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja për llogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt.

Shpërndarja e mandateve fillon me rend zbritës, në bazë të renditjes së tyre në listën shumëmemërore, duke filluar nga numri rendor një, si dhe numrit të votës parapëlqyese të secilit kandidat.

Rezultati për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për subjektin zgjedhor Koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim", sipas vendimit nr. 342, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është si më poshtë:



Nr.	Kandidatët e subjektit PD-AN			Gjinia	Vota parapëlqyese
	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	Helidon	Skender	Bushati	M	6.743
2	Emilja	Pjerin	Kolliqi	F	1.364
3	Ramadan	Rexhep	Likaj	M	4.778
4	Greta	Zef	Bardeli	F	2.753
5	Zef	Kin	Hila	M	5.975
6	Lodovik	Stak	Hasani	M	3.810
7	Bardh	Ali	Spahia	M	7.219
8	Nard	Lazer	Ndoka	M	228
9	Izmira	Niazi	Rusi (Ulqinaku)	F	3.683
10	Aldo	Rrok	Gega	M	1.832
11	Arben	Zef	Gjuraj	M	1.931
12	Helga	Ferdinand	Sallaku	F	1.069
Gjithsej					41.385

Sipas nenit 163, pika 3, të Kodit Zgjedhor, në fillim përfitojnë mandat kandidatët që kanë marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara nga subjekti në zonën zgjedhore. Në çdo rast, herësi nuk mund të jetë më shumë se 10 mijë vota.

Për subjektin zgjedhor Koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim" herësi është 9.441. Kandidatë me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi dhe që janë të renditur poshtë numrit 5 (pesë) të mandateve të fituara nga ky subjekt, nuk ka dhe në bazë të nenit 163, pika 1 dhe 6, shpërndarja e mandateve vijon sipas renditjes në listë.

Rezultati për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas vendimit nr. 342, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit PS			Gjinia	Vota parapëlqyese
	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	Edona	Xhavid	Bilali	F	2.711
2	Paulin	Nikollë	Sterkaj	M	7.335
3	Benet	Bahri	Beci	M	6.131
4	Ilir	Hamit	Beqaj	M	3.920
5	Frrok	Gjin	Gjini	M	1.521
6	Lela	Selami	Berdica	F	720
7	Pal	Prek	Peraj	M	310
8	Kristian	Luigj	Shkreli	M	625
9	Diana	Eqerem	Muriqi	F	190
10	Jona	Gjergj	Leqejza	F	495
11	Alda	Ded	Mema	F	744
12	Kabir	Sait	Fishta	M	921
Gjithsej					25.623



Për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë herësi është 10.099, pra merret 10 mijë. Kandidatë me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi dhe që janë të renditur poshtë numrit 3 (tre) të mandateve të fituara nga ky subjekt, nuk ka dhe në bazë të nenit 163, pika 1 dhe 6, shpërndarja e mandateve vijon sipas renditjes në listë.

Rezultati për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për subjektin zgjedhor Partia Socialdemokrate, sipas vendimit nr. 342, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit PSD			Gjinia	Vota parapëlqyese
	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	Tom	Gjek	Doshi	M	7.886
2	Gledis	Esat	Çeliku	M	949
3	Meri	Gasper	Markiçi	F	749
4	Bilbil	Nuh	Dervishi	M	278
5	Serdar	Qemal	Hoxha	M	1.279
6	Amela	Zyhdi	Zaganjori	F	292
7	Eduard	Frrok	Gjoka	M	452
8	Fabio	Rudolf	Martini	M	298
9	Marina	Angjelin	Duhani	F	307
10	Samed	Ahmet	Bushati	M	382
11	Ersen	Esat	Bala	M	55
12	Arjana	Muhamet	Ishmi	F	139
Gjithsej					13.066

Për subjektin zgjedhor Partia Socialdemokrate herësi është 8.212. Kandidatë me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi dhe që janë të renditur poshtë numrit 2 (dy) të mandateve të fituara nga ky subjekt, nuk ka dhe në bazë të nenit 163, pika 1 dhe 6, shpërndarja e mandateve vijon sipas renditjes në listë.

Kandidati i subjektit zgjedhor, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, z. Tom Doshi, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me shkrim, protokolluar në KQZ me shkresën nr. 4500, datë 26.04.2021, nëpërmjet së cilës deklaron se me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë jep dorëheqjen nga mandati si deputet pas zgjedhjeve të 25 Prillit 2021 dhe jep dorëheqjen nga lista shumëmemërore e kandidatëve për deputetë të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nëpërmjet kërkesës së tij me shkrim, z. Tom Doshi i kërkon KQZ-së të bëjë zëvendësimin e tij si deputet sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, në shkresën e tij, ai shprehet se sa më sipër kërkuar, është në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe se nuk ka as në datën 26 Prill 2021 (data e nënshkrimit të shkresës) dhe as në të ardhmen asnjë pretendim me



vendimin e KQZ-së sipas të cilit mandati i tij i kalon kandidatit tjetër sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Dorëheqja është e parevokueshme.

Në lidhje me këtë akt, sa i takon formës, Komisioneri konstaton se kërkesa për heqjen dorë nga mandati si deputet pas zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021 dhe dorëheqja nga lista shumemërore e kandidatëve për deputetë të PSD, përmban elementët formal të kërkuar nga ligji. Kërkesa është formuluar qartë dhe në mënyrë të padyshimtë sipas vullnetit të kërkuarit, përmban emrin e mbiemrin e kërkuarit, nënshkrimin e tij dhe vulën e subjektit zgjedhor PSD. Elementët formal të kërkesës janë në përputhje me nenet 80 e 81 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i cili përcakton se veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit. Shkresa mund të jetë e thjeshtë ose akt noterial. Veprimi juridik me shkresë duhet të nënshkruhet nga personi që e kryen atë.

Sa i takon përmbajtës së kërkesës, Komisioneri vlerëson se në përputhje edhe me parashikimet e nenit 79 të Kodit Civil, (i cili sanksionon së veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile), kërkuari ka shprehur në mënyrë të ligjshme vullnetin e tij për të hequr dorë nga e drejta e tij për të fituar mandatin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë pas zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021.

E drejta e z. Doshi për të fituar mandatin e deputetit klasifikohet si një e drejtë civile e politike, bazuar në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në të cilin Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.7510, datë 8.08.1991, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike", i cili shpall të drejtat themelore me karakter civil dhe politik që shtetet palë të tij duhet të garantojnë për të gjithë individët që hyjnë brenda juridiksionit të tyre. Ndër të drejtat e tjera, pakti garanton edhe të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Në vijim të këtij arsyetimi për asnjë shkak të ligjshëm një kandidati për t'u zgjedhur në një organ përfaqësues nuk mundet t'i jepet, apo nuk mundet të detyrohet të marrë mandatin për sa kohë i interesuara (kandidati) nuk ka vullnet për ta marr atë mandat (për t'u zgjedhur).

Në përmbushje të interesave të tij të ligjshëm, kandidati gëzon të drejtën për të zgjedhur me vullnet të plotë momentin se kur ta ushtrojë të drejtën për të hequr dorë nga fitimi i mandatit. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të detyrimeve të tij nuk mund të marrë një vendim duke l dhënë kërkuarit një të drejtë nga e cila ai vetë me vullnet të lire ka hequr dorë në mënyrë të parevokueshme. Referuar edhe vendimin të Gjykatës Kushtetuese, nr. 44, datë 7.10.2011, në të cilin Gjykata thekson se pasojat juridike të mandatit fillojnë në momentin që kandidati shpallet deputet nga KQZ-ja. Nga ky moment deputeti është i detyruar të plotësojë të gjitha kërkesat kushtetuese dhe ligjore që lidhen me



ndalimin e kryerjes së aktiviteteve të tjera apo deklarinimet lidhur me interesat e tij financiarë, siç parashikon Kushtetuta në nenin 70 të saj dhe ligjet e tjera përkatëse.

Me vendimmarrjen e tij Komisioneri nuk mund të cenoje interesin personal të ligjshëm të kandidatit i cili kërkon që në këtë moment të mos bëhet bartës i të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga akti i Komisionerit për të marrë mandatin e deputetit.

Nga analiza e mësipërme, Komisioneri në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, vijon me dhënien e mandatit kandidatit të radhës nga listës shumëmemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, për zonën zgjedhore, Qarku Shkodër.

Rezultati për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për subjektin zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, sipas vendimit nr. 342, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit LSI			Gjinia	Vota parapëlqyese
	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	Agron	Elez	Çela	M	2656
2	Edmond	Kol	Ndou	M	1809
3	Lindita	Enver	Reçi	F	215
4	Ilir	Sabri	Hyseni	M	260
5	Erlinda	Myzafer	Kavaja	F	156
6	Melisa	Festim	Brojaj	F	659
7	Somela	Fatmir	Radohina	F	181
8	Elsidita	Luan	Selaj	F	47
9	Ashim	Hysen	Tafilaku	M	131
10	Elmira	Nevrus	Zefi	F	54
11	Elvis	Sulejman	Metani	M	63
12	Jalldyz	Nuri	Kastrati	F	105
Gjithsej					6.336

Për subjektin zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim herësi është 10.100, pra merret 10 mijë. Kandidatë me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi dhe që janë të renditur poshtë numrit 1 (një) të mandatit të fituar nga ky subjekt, nuk ka.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 162 dhe 163, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar



V E N D O S:

1. Të shpërndaj mandatet për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, si më poshtë:
 - a) Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” 5 mandate
 - b) Partia Socialiste e Shqipërisë 3 mandate
 - c) Partia Socialdemokrate 2 mandate
 - ç) Lëvizja Socialiste për Integrim 1 mandat
2. Të shpall kandidatët fitues për deputetë për Qarkun Shkodër për subjektin zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, si më poshtë:

1.	Helidon	Skender	Bushati	PD
2.	Emilja	Pjerrin	Koliqi	PD
3.	Ramadan	Rexhep	Likaj	PD
4.	Greta	Zef	Bardeli	PD
5.	Zef	Kin	Hila	PD
3. Të shpall kandidatët fitues për deputetë për Qarkun Shkodër për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, si më poshtë:

1.	Edona	Xhavid	Bilali
2.	Paulin	Nikollë	Sterkaj
3.	Benet	Bahri	Beci
4. Të shpall kandidatët fitues për deputetë për Qarkun Shkodër për subjektin zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, si më poshtë:

1.	Gledis	Esat	Çeliku
2.	Meri	Gaspar	Makiçi
5. Të shpall kandidatët fitues për deputetë për Qarkun Shkodër për subjektin zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, si më poshtë:

1.	Agron	Elez	Çela
----	-------	------	------
6. Të miratoj rirenditjen e kandidatëve në listën shumemërore të subjektit zgjedhor koalicionin “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” të cilët nuk kanë përfutur mandat, në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave, si më poshtë:



Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese
6	Bardh	Ali	Spahia	M	7.219
7	Lodovik	Stak	Hasani	M	3.810
8	Izmira	Niazi	Rusi (Ulqinaku)	F	3.683
9	Arben	Zef	Gjuraj	M	1.931
10	Aldo	Rrok	Gega	M	1.832
11	Helga	Ferdinand	Sallaku	F	1.069
12	Nard	Lazer	Ndoka	M	228

7. Të miratoj rirenditjen e kandidatëve në listën shumemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë të cilët nuk kanë përfutur mandat, në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave, si më poshtë:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese
4	Ilir	Hamit	Beqaj	M	3.920
5	Frrok	Gjin	Gjini	M	1.521
6	Kabir	Sait	Fishta	M	921
7	Alda	Ded	Mema	F	744
8	Lela	Selami	Berdica	F	720
9	Kristian	Luigj	Shkreli	M	625
10	Jona	Gjergj	Leqejza	F	495
11	Pal	Prek	Peraj	M	310
12	Diana	Eqerem	Muriqi	F	190

8. Të miratoj rirenditjen e kandidatëve në listën shumemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë të cilët nuk kanë përfutur mandat, në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave, si më poshtë:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese
3	Serdar	Qemal	Hoxha	M	1.279
4	Eduard	Frrok	Gjoka	M	452
5	Samed	Ahmet	Bushati	M	382
6	Marina	Angjelin	Duhani	F	307
7	Fabio	Rudolf	Martini	M	298
8	Amela	Zyhdi	Zaganjori	F	292
9	Bilbil	Nuh	Dervishi	M	278
10	Arjana	Muhamet	Ishmi	F	139
11	Ersen	Esat	Bala	M	55

9. Të miratoj rirenditjen e kandidatëve në listën shumemërore të subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim të cilët nuk kanë përfutur mandat, në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave, si më poshtë:



Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese
2		Kol	Ndou	M	1809
3	Melisa	Festim	Brojaj	F	659
4	Ilir	Sabri	Hyseni	M	260
5	Lindita	Enver	Reçi	F	215
6	Somela	Fatmir	Radohina	F	181
7	Erlinda	Myzafer	Kavaja	F	156
8	Ashim	Hysen	Tafilaku	M	131
9	Jalldyz	Nuri	Kastrati	F	105
10	Elvis	Sulejman	Metani	M	63
11	Elmira	Nevrus	Zefi	F	54
12	Elsidita	Luan	Selaj	F	47

10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 2

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:

Q. Peto: _____

M. Koja: _____

N. Mezzani: _____

M. Çelmeta: _____

A. Lançe: _____

Y. Merkaj: _____

Nr. _____ prot


Tiranë, më _____.2021



Data: 23 Qershor 2021
Nr. 410

Për shpërndarjen e mandateve në qarkun Shkodër për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021

Partie : LËVIZJA SHKIPËRIA BEKET



RR785951096AA

Merr: KOMISIONI QENDRORE
I ZGJEDHJEVE, TIRANE
R. IBRAHIM RUGOVA
nr 4